



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 17.12.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBI MI ME 1, 5-34 KATE MBI TOKË DHE 5 KATE
PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “E.H.W” sh.p.k., “Lion Construction” sh.p.k., dhe “Pitagora Konstruksion” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 5-34 kate mbi tokë dhe 5 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “E.H.W” sh.p.k., “Lion Construction” sh.p.k., dhe “Pitagora Konstruksion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 52, datë 02.04.2024 “Për miratimin të Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 34 kate mbitokë me 5 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, shfuqizohet.



5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËRI I LINJËS
MINISTËRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU 9.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshtkruar më datë 12/02/2025